



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 142, datë 22.04.2020

**PËR
RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NË
KUSHTET E LEHTËSIMIT TË MASAVE TË MARRA PËR KUFIZIMIN E
PËRHAPJES SË COVID-19**

Këshilli i Lartë i Gjyqësor bazuar në nenet 147/1, 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Përkohshëm të ngritur me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020, me qëllim hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, në situatë epidemike të shkaktuar nga virusi COVID-19,

VENDOSI:

1. Rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përputhje me rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjen e covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.
2. Rifillimin e procedurave administrative të pezulluara:
 - a) për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë;
 - b) për ngritjen në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar;
 - c) për komandimin në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - ç) për komandimin në Shkollën e Magjistraturës;
 - d) për komandimin në Ministrinë e Drejtësisë.
3. Në funksion të pikës 2 të këtij vendimi, zgjatjen e afateve të kandidimit:
 - a) me një javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 2 javor);
 - b) me një muaj, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.83 dhe nr.86, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 2 muaj);
 - c) me një javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.88 dhe nr.93, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 2 javor);

- ç) me dy javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.89 dhe nr.94, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 4 javor);
 - d) me tre javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.90 dhe nr.95, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 6 javor);
 - dh) me katër javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.91 dhe nr.96, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 8 javor);
 - e) me pesë javë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për pozicionet e shpallura me vendimet nr.92 dhe nr.97, datë 26.02.2020 (vendimet me afat 10 javor);
 - f) me një javë, në procedurat e komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për pozicionet e shpallura me vendimin nr.98, datë 26.02.2020;
 - g) me një javë, në procedurën e komandimit në Shkollën e Magjistraturës, për pozicionin e shpallur me vendimin nr.99, datë 26.02.2020;
 - gj) me një javë, në procedurat e komandimit në Ministrinë e Drejtësisë, për pozicionet e shpallura me vendimin nr.100, datë 26.02.2020.
4. Rifillimin e procedurës administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR